



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e XII-të për vitin 2011, e Kuvendit Komunal në Vushtri, mbajtur më 29.12.2011

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën **10:08**.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muharrem Shabani, Naile Osmani, Nysret Gërxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Sylja, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Xhemajl Pllana, Xhylsime Feka dhe Zeqir Hasani.

Munguan: Gani Imeri, Vlora Qirezi.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe: kryetari i komunës, nënkryetari i komunës, drejtorët e drejtorive komunale, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues të Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të ICO-së (Zyra Civile Ndërkombëtare), dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Ferit Idrizi, kryesues i Kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- paraqiti rendin e ditës ashtu siç është paraparë në ftesë, kurse në “të ndryshme” propozoi që të futet fjalimi përshëndetës i kryetarit të komunës, në rastin e përfundimit të vitit kalendarik.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- tha se pasi që u nda nga jeta dr.Shaban Merovci, i cili gjysmë shekulli i shërbeu shëndetësisë së Vushtrrisë dhe të Kosovës, dhe njëri ndër themeluesit e shkollës së mesme të mjekësisë në Mitrovicë, propozoi që kuvendi i komunës ta nderojë me 1 minut heshtje.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- duke u pajtuar me propozimin e P.Pllanës, kërkoi që të mbahet 1 minut heshtje për nder të veprës së dr.Shaban Merovcit.

Pas mbajtjes së 1 minuti heshtjeje, vazhduan punimet e kuvendit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se është obligim i yni që të kemi kujdesin për njerëzit që kanë kontribuar, dhe në rastin konkret bëhet fjalë për një

kontribuues në lëmin e shëndetësisë, dhe është i pari ndër shqiptarët e Kosovës që ka dhënë kontributin në mjekimin e popullatës, gjithashtu dha kontribut edhe në ngritjen e arsimit të mjekësisë, prandaj propozoi që t'i vëhet emri i dr. Shaban Merovcit një institucioni shëndetësor në Vushtrri.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar rendit të ditës tha se në planin e punës së kuvendit për vitin 2011, për muajin dhjetor ka qenë e paraparë që kryetari i komunës të paraqesë para kuvendit planin e punës për vitin 2012, kurse mungon kjo pikë e rendit të ditës, prandaj shtoi se është e nevojshme që kuvendit t'i prezantohet plani i punës së kryetarit të komunës për vitin 2012.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar vërejtjes së B. Jasharit, tha se LVL-ja nuk e parasheh që kryetari i komunës obligohet që planin e vet të punës t'ia prezantojë kuvendit për aprovim.

Xhemajl Pllana, anëtar i kuvendit- tha se familja e heroit Xhavit Haziri që 12 vite e ka shtëpinë të pameremetuar, prandaj propozoi që prindërve të heroit në fjalë t'i meremetohet shtëpia, e cila ndodhet në Druar.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke e mbështetur propozimin për prindërit e heroit Xhavit Haziri, shtoi se propozimet e tilla duhet të paraqiten me kohë, pasi që planifikimi për vitin e ardhshëm ka përfunduar, dhe i vetmi fond që mund të shfrytëzohet janë subvencionet. Në vazhdim përmendi edhe rastin e familjes së Selatin Gërxhaliut, duke propozuar që shtëpia aktuale ku jetojnë anëtarët tjerë të kësaj familjeje, e në të cilën janë vrarë të gjithë anëtarët e familjes së tij, të shndërrohet në muze, dhe të ndërtohet një shtëpi tjetër për ta.

Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë unanime miratoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.
 2. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake për muajt tetor dhe nëntor 2011.
 3. Shqyrtimi i propozim-planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012.
 4. Shqyrtimi i Organogramit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012 (shqyrtimi i dytë).
 5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.
 6. Të ndryshme:
- Fjalimi i kryetarit të komunës me rastin e përfundimit të vitit 2011.**

1. Shqyrtimi i Procesverbalit nga mbledhja paraprake e KK-së.

Aprovohet në mënyrë unanime procesverbali i mbledhjes së kuvendit të komunës.

2. Shqyrtimi i Informatës për të hyrat vetanake për muajt tetor dhe nëntor 2011.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- tha se në bazë të informatës në fjalë, del se në proporcion me planin është realizuar 90.22 %, kurse në krahasim me vitin e kaluar ka një tejkalim prej 34.68 %. Mirëpo shtoi se plani është realizuar 90.22 % fal donacionit të PTK-së, i cili është 70.000 €, kurse shuma e tillë nuk është e paraparë as në plan, dhe sikur të mos kishte ndodh ky donacion, realizimi i planit do të ishte 61.25 % i të hyrave vetjake për dy muaj. Kurse sa i përket të hyrave vetjake, tha se vazhdimisht po paraqet vërejtjet e tij, por nuk po bëhen përmirësime nga Drejtoria

për Buxhet, dhe shtoi se realizimi i këtyre të hyrave, nuk është i këtyre dy muajve të këtij viti, por një pjesë e konsiderueshme e këtyre të hyrave janë të viteve paraprake, prandaj në çdo informatë duhet të jetë një shtyllë e cila pasqyron arkëtimin e të hyrave nga vitet e kaluara. Në vazhdim paraqiti vërejtje tek planifikimi dhe tha se planifikimi nuk është real, duke shtuar se tek qiraja e objekteve komunale nuk është paraparë fare planifikim, kurse janë realizuar të hyra. Po ashtu tek pranimet teknike nuk është paraparë që të bëhet asnjë pranim teknik, asnjë pëlqim sanitar. Pastaj tha se tek administrata, planifikimi ka qenë 8.500 €, në vitin e kaluar realizimi ka qenë 9.791 €, ndërsa realizimi në këtë periudhë është 11.000 €, prandaj pyeti pse ky planifikim, pasi që në vitin e kaluar janë realizuar 9.791 €? Pastaj te lejet urbanistike nuk ka fare planifikim, kurse janë realizuar të hyra. Gjithashtu pyeti pse është ky planifikim tek “shfrytëzimi i pronës komunale (kiosqet)”? Te “listat poseduese, kopje plani, vërtetime tjera” nuk ka fare planifikim, kurse në vitin e kaluar në këtë periudhë janë realizuar të hyra 2.809 €. Te “lejet e punës” është planifikuar shuma 1.833 €, kurse realizimi është shumë i vogël. Te “qiraja e tregut” është bërë një planifikim prej 2.583 €, kurse tregu është dislokuar. Te “ndërrimi i tokës bujqësore në ndërtimore” planifikimi është shqetësues, ku janë paraparë 1.000 €, kurse janë realizuar 4.422 €, mirëpo është shqetësuese që është tejkaluar shumë plani, pasi që po nxinet toka bujqësore. Te “bibliotekat” nuk ka planifikim fare, kurse janë realizuar 167 €; Te “qendra e kulturës” nuk ka planifikim fare; Te “ndalja e veturave në rrugë” nuk ka fare planifikim, edhe pse vitin e kaluar ka pasur të hyra; Te “gjobat e gjykatës” pyeti se për çfarë gjoba bëhet fjalë, kurse për shtyllën “të tjerat”, tha se nuk është dashtë të mbetet ky emërtim për një shumë të planifikuar prej 8.333 €; Te “çerdhet” është planifikuar shuma 27.500 €, kurse vitin e kaluar janë realizuar 7.227 €, prandaj pyeti pse është ky planifikim kaq i madh, kurse realizimi është i ngjashëm me vitin e kaluar; Te “arsimi i mesëm” nuk ka fare planifikim të hyrash, kurse tek “tatimi në pronë” është dashtë të ndahen dy periudha: në bazë të bazës tatimore cilat janë inkasimet, dhe të ndahet prej interesave tatimore.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar informatës në fjalë, tha se do të ishte mirë që të paraqiten sqarime në fund të tabelës të paraqitur në këtë informatë.

Isuf Jashari, drejtor i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa- duke iu referuar informatës në fjalë dhe vërejtjeve të paraqitura, tha se kur është koha të debatohet për planifikimin, disa deputetë nuk e shikojnë fare formularin e të hyrave, pra planifikimi në fjalë nuk mund të ndryshohet, pasi që si i tillë është aprovuar në shtatorin e vitit të kaluar për vitin 2011, kurse shumat variojnë, ndërsa për disa pozicione nuk është paraparë planifikim i të hyrave, kurse te pozicioni “arsimi i mesëm”, këto të hyra deri në fund të vitit të kaluar kanë qenë në Ministrinë e Arsimit, ndërsa pasi që është aprovuar buxheti, kanë kaluar në të hyra vetanake të komunës. Ndërsa lidhur me realizimin, tha se inkasimi varion prej muajit në muaj. Mandej lidhur me shpërndarjen se cilit vit i takojnë, tha se kur bëhen pagesat dhe e marrim raportin nga banka, aty nuk ceket se për cilin vit është pagesa, prandaj është e pamundur të specifikohet lloji i të hyrave dhe cilit vit i përket. Në fund tha se në fund të vitit paraqitet raporti në detaje, që tregon se është i tejkaluar planifikimi.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- sqaroi se nuk ka kërkuar që të ndryshohet plani, por ka vlerësuar që planifikimi nuk është në rregull. Kurse te tatimi në pronë, dihet që tatimpaguesit nuk e cekin periudhën për të cilën po paguajnë, por drejtoria i ka ngarkesat dhe në bazë të tyre duhet të shikohet që t’iu shlyhen borxhet nga fillimi.

3. Shqyrtimi i propozim-planit të punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit- Grupi parlamentar i PDK-së e përkrah propozim-planin e punës në fjalë, duke propozuar që në muajin janar të paraqitet propozim-vendimi për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores së punës së

kuvendit, kurse në muajin shkurt të paraqitet Draft-rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës. Ndërsa në muajin prill të përgatitet Draft-rregullorja për ndarjen e mirënjohjeve dhe plaketave për Ditën e Çlirimit.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- duke iu referuar planit të punës në fjalë, në emër të Grupit parlamentar të LDK-së propozoi që në fillim të planit të punës të jetë sfondi dhe të përfshihet kur është themeluar për herë të parë Komuna e Vushtrisë, pastaj të renditet së pari synimi me këtë përmbajtje: “mbizotërimi i frymës demokratike në kuvendin e komunës dhe siguri i ligjshmërisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik që të shpie kah mirëqenia e gjithëmbarshme e qytetarëve”, mandej duhet radhitur objektivat, dhe mund të jetë një ose grup objektivash, dhe pas objektivave vjen qëllimi, duke shtuar se përveç 4 objektivave, e që janë: Identifikimi i nevojave të domosdoshme për trajtim në kuvend; krijimi i mundësive të barabarta për të gjithë anëtarët e kuvendit; respektimi i planit të punës dhe rregullores së punës së kuvendit; rritja e transparencës, të tjerat nuk janë objektiva. Mandej pasi që të paraqitet synimi, duhet të jetë një mbititull me këtë përmbajtje: “itinerari i punëve dhe aktiviteteve”. Kurse për muajin shtator propozoi që në fillim të muajit shtator të shqyrtohet projekt-buxheti, pastaj të shkojë në shqyrtim publik, dhe pas shqyrtimit publik të vijë në kuvend për t’u aprovuar.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar planit të punës në fjalë, propozoi që Informata për përfundimin e vitit shkollor 2011/2012 dhe përgatitjet për vitin shkollor 2012/2013 të paraqiten në muajin shtator, pasi që viti shkollor përfundon në muajin gusht, kurse në shtator fillon viti i ri shkollor.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit parlamentar të LDK-së paraqiti këto propozime për t’i futur në plan të punës: në janar të paraqitet propozim-vendimi për caktimin e lokacionit për ngritjen e shtatores së Hasan Prishtinës, prandaj Grupi parlamentar i LDK-së ka përgatitur propozim-vendimin për çështjen në fjalë, pastaj tha se në seancën e kaluar është aprovuar vendimi që cakton ditën e patates në Vushtri, kurse mungon si aktivitet në muajin tetor manifestimi i ditës së patates në Komunën e Vushtrisë; në fund tha se në planin e punës të vitit 2011, në muajin tetor ka qenë shqyrtimi i parë për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për punën e kuvendit, kurse është dashtë të jetë në nëntor shqyrtimi i dytë, por nuk është, ndërsa i njëjti në planin e punës së kuvendit për vitin 2012 nuk është fare, prandaj propozoi që të futet në muajin prill propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për punën e kuvendit.

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- duke iu referuar planit të punës në fjalë, tha se ky plan është dashtë të jetë në mbështetje të planit të punës së kryetarit të komunës, pasi që kuvendi nuk mund të hartojë një plan nëse nuk dihen objektivat dhe angazhimet e qarta se për çka angazhohet kryetari i komunës, sepse objektivat e komunës janë edhe objektiva të kuvendit. Pastaj tha se renditja duhet bërë kështu: synimi, qëllimi, objektivat, pasi që renditja në këtë plan nuk është e mirë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- duke iu referuar planit të punës në fjalë, tha se komuna ka pasur plan të punës edhe në mandatet e kaluara. Pastaj tha se nëse kuvendi është organi më i lartë në komunë, duhet ta respektojmë të gjithë, prandaj objektivat dhe synimeve të kuvendit duhet t’iu përmbahet edhe kryetari i komunës. Mandej tha se plani i punës në fjalë është i cekët, pasi që nuk përfshin të gjitha përgjegjësitë vetanake të garantuara me LVL. Në vazhdim tha se duhet të ketë raport të punës nga auditimi i brendshëm, së paku një herë në vit. Gjithashtu është e nevojshme të kemi në rend dite: çështjen e shërbimeve publike, furnizimi me ujë, pastrimi i mbeturinave dhe ambientit; mirëqenien sociale, strehimin familjar, përkujdesjen për të moshuarit; bashkëpunimin me shoqërinë civile, si formë e pjesëmarrjes së qytetarëve drejtpërdrejt në kuvend; çështjen e kontrollit të standardit të ndërtimit në komunën tonë, pra me çfarë standarde po ndërtohen objektet e banimit, veçanërisht objektet shumëkatëshe, dhe shtoi se është obligim

ligjor mbikëqyrja, prandaj kërkoi informatë se si është gjendja e këtyre ndërtimeve, a është bërë pranimi teknik i tyre, si është çështja juridike pronësore e tyre në përgjithësi, dhe kualiteti a përputhet me sipërfaqet që i kemi, pasi që shumë objekte nuk përputhen; çështjen e të punësuarëve, pra është e nevojshme që të informohemi për strukturën e tyre në sektorin privat dhe në sektorin publik, prandaj edhe për këtë kërkoi informatë përmes së cilës do të njoftohej kuvendi; sa biznese janë, sa janë aktive dhe sa pasive; çështjen e ambientit dhe mbrojtjes së pronave, dhe veçanërisht mbrojtjen e lumenjve nga degradimet; çështjen e mbrojtjes së pyjeve. Në vazhdim tha se kuvendi ka nevojë që ta shqyrtojë edhe çështjen e sigurisë, prandaj është e nevojshme që të parashikohet me plan të punës raporti i KKSB-së. Gjithashtu të ketë raport pune nga Komiteti për Mbrojtje dhe Shpëtim. Kurse në faqen 6, kërkoi që të hiqet fjalia “mbi pozicionet serbe”, dhe në vend të saj të thuhet “kundër pozicioneve të forcave të armatosura serbe”.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar planit të punës në fjalë, propozoi që të theksohet në këtë plan, te parathënia se parimi kryesor dhe i përhershëm në planin e punës së kuvendit duhet të jetë: barazia, demokracia dhe qeverisja e mirë. Gjithashtu propozoi që të theksohet te parathënia se kuvendi i komunës është organ mbikëqyrës. Mandej tha se në këtë plan nuk janë shkoqitur sa duhet temat lidhur me KPF-në, prandaj propozoi që në janar të parashihet edhe raporti i KPF-së, duke e pasur parasysh rëndësinë e KPF-së. Pastaj tha se duhet të gjendet një model i bashkëpunimit në mes të ekzekutivit dhe legjislativit. Po ashtu buxheti, financat, paraja publike janë shumë të rëndësishme për t'i analizuar, dhe shtoi se në këtë plan janë parashikuar raportet për tremujorin dhe gjashtëmujorin, por mungon nëntëmujori, prandaj propozoi që të ketë edhe raport për nëntëmujorin. Në vazhdim paraqiti edhe këto propozime: për muajin shtator, propozoi që të ketë vizitë zyrtare për anëtarët e kuvendit për të përfutur përvoja të reja; kurse muaji nëntor të mos mbetet blanko, por të plotësohet me disa pika të rendit të ditës nga muajt tjerë, dhe propozoi që në këtë muaj të përgatitet raport për situatën ekonomiko-financiare për nëntëmujorin e vitit 2012. Në fund tha se edhe aktivitetet duhet të paraqiten në mënyrë më të shkoqitur.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- duke iu referuar planit të punës në fjalë, tha se gjatë këtij viti ka pas mbledhje të KK-së me shumë pika të rendit të ditës, kurse ka pasur mbledhje vetëm me 2 apo 3 pika të rendit të ditës, prandaj kërkoi që të bëhet një balancë e mbledhjeve. Pastaj propozoi që në planin e punës në fjalë të figurojë edhe fjalimi i kryetarit të komunës në rastin e përfundimit të vitit kalendarik. Mandej paraqiti vërejtje se në planin e punës së kuvendit për vitin 2011 ka qenë i paraparë edhe plani i punës së kryetarit, por ai plan nuk po respektohet, pasi që nuk është paraqitur plani i punës së kryetarit para kuvendit. Në vazhdim tha se plani i punës së kryetarit duhet të harmonizohet me planin e punës së kuvendit, prandaj ka nevojë për një bashkëpunim më të ngushtë në mes të kryetarit të komunës dhe kryesuesit të kuvendit. Po ashtu tha se do t'i shërbente transparencës dhe gjithëpërfshirjes nëse edhe kryetari i komunës e paraqet para kuvendit planin e tij të punës, pasi që ka një përfshirje më të gjerë të të gjithë atyre që dëshirojnë që kryetari i komunës ta ketë një plan të punës përmbajtësor, të realizueshëm dhe konkret. Në fund kërkoi që kuvendi të ketë informata mbi gjendjen sociale, pasi që aktualisht ka familje me gjendje shumë të rëndë edhe lidhur me strehimin, ushqimin, prandaj kuvendi duhet të preokupohet dhe të debatojë për mënyrat e përkrahjes së atyre njerëzve, gjithashtu të diskutohet edhe për cilësinë e ujit të pijshëm.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar diskutimeve të anëtarëve të kuvendit lidhur me planin e punës në fjalë, tha se është e nevojshme që në të ardhmen kryesuesi i kuvendit të organizojë një punëtori të veçantë me subjektet politike për ta përgatitur një plan të mirë për punën e kuvendit, para se të procedohet plani i punës në KPF dhe kuvend. Pastaj lidhur me kërkesën për të përcaktuar lokacionin për ndërtimin e shtatores së Hasan Prishtinës, tha se ka

menduar edhe më herët që njëri nga lokacionet e mundshme për ndërtimin e shtatores në fjalë është përballë objektit të ri të komunës, e cila është në ndërtim e sipër, por paraprakisht duhet të merret vendimi për rrënimin e objektit të vjetër të komunës, mandej vendimi për rregullimin e oborrit të komunës dhe në fund vendimi për ndërtimin e shtatores së Hasan Prishtinës. Kurse sa i përket auditimit të brendshëm, tha se në bazë të ligjit, nuk është i obliguar kryetari i komunës ta paraqes para kuvendit raportin e auditorit të brendshëm.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- lidhur me planin e punës në fjalë, tha se u propozua që si aktivitet të futet për muajin shtator organizimi i një punëtorie me anëtarët e kuvendit rreth hartimit të planit të punës së kuvendit. Pastaj u propozua që muaji nëntor të plotësohet me disa aktivitete. Në vazhdim tha se u paraqiten këto propozime që të futen në planin e punës së kuvendit dhe disa propozime që të zhvendosen prej muajve në muaj të tjerë disa pika të rendit të ditës: Informata për cilësinë e ujit të pijshëm, për higjienën, për mbrojtjen e ambientit; Informata për përfundimin e vitit shkollor dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor, të diskutohen në muajin shtator; renditja të jetë: synimi, qëllimet, objektivat dhe aktivitetet; te sfondi të futet edhe një kronologji e shkurtë; të vëhen edhe kompetencat e kuvendit, të cilat janë kompetenca të padeleguara; të futet një vizitë pune e anëtarëve të kuvendit gjatë muajit shtator. Mandej njoftoi se USAID-i do të pajisë kuvendin e komunës me teknikën elektronike për të debatuar nga vendi, prandaj në muajin janar duhet të fusim në planifikim propozim-vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores së punës së kuvendit.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012, duke inkorporuar propozimet e anëtarëve të kuvendit, të cilat i ka përmbledhur në fund të diskutimit kryesuesi i kuvendit.

4. Shqyrtimi i Organogramit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012 (shqyrtimi i dytë).

Veli Karaça, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i LDK-së e mbështet këtë strukturë organizative, dhe njëkohësisht i sugjeroi kryetarit të komunës që në bazë të prioriteteve që i ka kryetari, çdoherë kur ndryshojnë prioritetet, të ketë kompetencën edhe për ta ristrukturuar administratën brenda komunës, pasi që prioritetet ndryshojnë dhe askush nuk mund të mbetet peng i një vendimi që e pengon përmbushjen e qëllimit dhe arritjen e objektivave.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar organogramit, tha se edhe herën e kaluar ka kërkuar sqarime, pasi që është e paqartë vetëm figurimi në organogram, prandaj paraqiti kundërshtimin ndaj një administrate e cila nuk është efikase, sepse çdo zyrtar i administratës duhet ta ketë një referat, dhe referati i tillë të jetë në shërbim të qytetarëve. Pastaj kërkoi që të ketë raporte të punës nga komitetet konsultative, dhe shtoi se akoma nuk ka marrë përgjigje se a paguhen dhe si paguhen komitetet në fjalë. Mandej lidhur me Zyrën Ligjore dhe Avokatin Publik, pyeti a është avokati i komunës, apo është avokati publik, dhe nëse është avokati i komunës, avokati është dashtë të dalë me një raport, pasi që në bazë të informacioneve, Komuna e Vushtrrisë nëpër kontestet gjyqësore ka pësuar fiasko, duke humbur shumë mjete të taksapaguesve tanë. Mandej lidhur me Zyrën për Integritet Evropian, pyeti cili është roli i kësaj zyre në komunë, cili është ai që i bën integritet evropian dhe cila është potencia e tij për të ndikuar në integritet evropian? Në vazhdim tha se nëse krijohet zyra për projekte, nuk ka nevojë që të ekziston zyra tjetër.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- lidhur me pyetjen rreth funksionimit të komiteteve konsultative, tha se në planin e punës së kuvendit për vitin 2012 janë paraparë raportet vjetore të punës së komiteteve në fjalë.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- duke iu referuar organogramit në fjalë, tha se në organogram duhet të jetë edhe Komiteti për Auditim, i cili luan rolin e mbikëqyrësit në dobi të parasë publike.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- duke iu referuar kërkesës për të qenë në organogram edhe Komitetit për Auditim, tha se Komiteti për Auditim ekziston, dhe këtë komitet e ka formuar kryetari i komunës, dhe e mbështeti kërkesën që komiteti në fjalë të figurojë në organogram. Mandej tha se Komiteti për Auditim është duke funksionuar dhe ka mbajtur disa takime, por një ndër problemet është mënyra e kompensimit për Komitetin për Auditim dhe për komitetet konsultative, por premtoi se në vitin e ardhshëm do ta marrin kompensimin komitetet në fjalë për çdo takim që kanë mbajtur. Në vazhdim tha se Zyra për Integrime Evropiane është funksionale, dhe avokatja e komunës është e angazhuar për kryerjen e detyrave në këtë zyrë. Pastaj propozoi që të mbetet një sekretari e vetme që kryen shërbimet për kryetarin e komunës dhe për kuvendin e komunës. Në fund tha se nuk ka nevojë të ketë zyrë të veçantë për partneritet publiko-privat, por le të mbetet zyra për planifikim dhe zhvillim ekonomik, e cila duhet të quhet planifikimi, zhvillimi ekonomik dhe partneriteti publiko-privat.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- tha se është shumë e logjikshme që duhet të jetë si sekretari e kuvendit për shkak të efikasitetit të punës, kurse duhet t'i raportojë kryetarit të komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Aprovohet Organogrami i Komunës së Vushtrrisë për vitin 2012, duke inkorporuar propozimet e paraqitura gjatë diskutimit për pikën e rendit të ditës në fjalë.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për plotësimin e Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale.

Nasuf Aliu, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi dhe Bujqësi- paraqiti sqarimet hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se e mbështet çdo përpjekje që bën ekzekutivi i komunës me qëllim të përmirësimit të klimës së të bërit biznes në Komunën e Vushtrrisë, duke shtuar se është edhe obligim i ekzekutivit për të krijuar kushte sa më të mira për biznese. Pastaj tha se propozim-vendimi në fjalë e vërteton faktin që Komuna e Vushtrrisë nuk bën shumë për biznese, dhe pyeti se a janë identifikuar pengesa tjera për të bërit biznes, pasi që në Vushtri, por edhe në Kosovë ka pengesa të shumta, prandaj është detyrë e Pushtetit Komunal në Vushtri që t'i identifikojë ato pengesa që bizneset i theksojnë.

Ismet Gashi, anëtar i kuvendit- paraqiti vërejtje në titullin e propozim-vendimit, dhe propozoi t'i shtohet: "vendim për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores...", kurse te neni 1, propozoi këtë tekst: "me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet neni 35.1 i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01Nr.742/08, dhe do ta ketë këtë përmbajtje: 'Subjektet afariste me rastin e aplikimit për leje-pune, lirohen nga pagesa e taksës'. Gjithashtu propozoi që sekretaria në bashkëpunim me organet tjera komunale ta bëjnë një tekst të spastruar të rregullores që është aprovuar me 30.12.2008.

Qazim Azemi, anëtar i kuvendit- tha se Grupi parlamentar i AAK-së e mbështet propozim-vendimin në fjalë, i cili shkon në favor të subjekteve afariste.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 30 vota "për", 1 "kundër", të tjerët "abstenim" vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet neni 35.1 i Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale 01Nr.742/08, dhe do ta këtë këtë përmbajtje: "Subjektet afariste me rastin e aplikimit për leje-pune lirohen nga pagesa e taksës".

6. Të ndryshme:

Fjalimi i kryetarit të komunës në rastin e përfundimit të vitit 2011.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se qeveria komunale ka arritur që të realizoj pjesën absolute të projekteve të parapara në buxhetin e këtij viti të planifikuar në vitin e kaluar. Gjithashtu qeveria komunale ka arritur të realizojë edhe projekte tjera qoftë nga mjetet që kanë tepruar, ose përmes donatorëve të ndryshëm. Në vazhdim njoftoi se brenda vitit 2011 janë realizuar 192 kontrata publike, dhe prej të gjitha këtyre kontratave, vetëm një kontratë publike ka dështuar, dhe ky dështim ka ndodhur për shkak se një kompani nuk ka qenë e përgjegjshme. Pastaj tha se prej këtyre projekteve, 36 projekte janë realizuar nga të hyrat e komunës në vlerë prej 4.969.000 €, ndërsa investimet nga Qeveria e Kosovës kanë qenë 1.850.860 €, e të cilat kanë qenë për asfaltim të rrugëve dhe brenda këtij viti janë asfaltuar 69.426 metra gjatësi asfalt, dhe në kuadër të këtyre projekteve hyjnë edhe projektet që vitin e kaluar kanë hyrë si projekte të Qeverisë së Kosovës, e të cilat kanë përfunduar këtë vit. Kurse janë realizuar 24 projekte në kubëza në gjatësi prej 5 kilometrave në vlerë prej 280.347 €, kurse janë realizuar edhe 64 projekte të tjera kapitale, disa prej tyre janë: përfundimi i ndërtimit të shkollës në fshatin Bukosh; ka filluar ndërtimi i shkollës në Zhilivodë; vazhdon ndërtimi i shkollës së mesme të gjimnazit në qytet, e që është investim nga Qeveria e Kosovës; ka përfunduar ndërtimi i QKMF-së në Vushtrri dhe ka filluar të funksionojë, e që është investim nga Komisioni Evropian; është në përfundim ndërtimi i urës në Prelluzhë; ka përfunduar ndërtimi i stacionit të pompimit në Ashlan për ujitjen e tokës; ka filluar ndërtimi i objektit të komunës; është zhvendosur tregu i vjetër, dhe është duke funksionuar tregu i ri me infrastrukturë përcjellëse; është duke u bërë restaurimi i kalasë së qytetit; ka përfunduar ndërtimi i Kullës së Azem Bejtë Galicës; ka përfunduar faza e parë për restaurimin e muzeut në ish-shtëpinë e Mahmut Agë Gjinollit. Ndërsa sa i përket të hyrave vetanake, tha se duke përfshirë edhe donacionet, është me rëndësi që plani po realizohet, dhe deri më tani të hyra vetanake kanë qenë 1.285.779 €, kurse planifikimi është 1.315.000 €, dhe shtoi se në këtë shumë nuk është përfshirë shuma nga vendimet e gjykatës, e cila arrin 61.000 €, dhe nga kjo nënkuptohet që është krijuar mundësia që të realizohen të gjitha projektet që janë planifikuar. Po ashtu falënderoi donatorët siç janë: USAID-i, Komisioni Evropian, OSBE-ja. Mandej falënderoi për bashkëpunim shumë të mirë: Zyrën Civile Ndërkombëtare, KFOR-in, në veçanti ish-komandantin e KFOR-it, Buhler; KFOR-in sloven (LMT), përfaqësuesin e MAPL-së, organizatat joqeveritare, organizatat e dalura nga lufta, drejtorët e shkollave, drejtorët e institucioneve shëndetësore, punëtorët e arsimit dhe të shëndetësisë, që fal kontributit të tyre kanë ndikuar që të përmirësohet jeta e të gjithë qytetarëve, duke ngritur cilësinë në mësim, në shëndetësi dhe në edukim, dhe në mënyrë të veçantë falënderoi kryesuesin e kuvendit për bashkëpunim gjatë tërë vitit, për anëtarët e kuvendit, për mediat dhe për stafin e administratës komunale.

Në fund duke iu dëshiruar të gjitha të mirat në jetë, ua uroi vitin e ri 2012 të gjithë qytetarëve të Komunës së Vushtrrisë.

Ferit Idrizi, kryesues i kuvendit- ua uroi të gjithëve vitin e ri 2012.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se kryetari i komunës është dashtë t'i u kërkojë falje qytetarëve për problemet e furnizimit me ujë gjatë gjithë vitit; për problemet e furnizimit me rrymë gjatë gjithë vitit; për problemet e strehimit dhe të skamjes.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- tha se nënkuptohet që të gjitha nevojat që i kanë qytetarët e Komunës së Vushtrrisë nuk janë realizuar, por janë realizuar aq sa ka pasur buxhet dhe mundësi, kurse të pastrehët janë furnizuar me material ndërtimor me aq sa Komuna ka pas mundësi, ndërsa lidhur me çështjen e furnizimit me ujë të pijshëm, tha se fabrika e ujit është duke u ndërtuar me një dinamikë të jashtëzakonshme, dhe në këtë mënyrë do të zgjidhet problemi i furnizimit me ujë të pijshëm për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

Procesmbajtësi:
Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit
Ferit Idrizi

Lektore:
Vlora Krasniqi